

Çfarë mund të bëjnë prindërit për të parandaluar sajberdhunën?

Mos i fshini mesazhet nga sajber-ngacmuesit, mbani ato si dëshmi. Sa më shumë të keni dëshmi, aq më lehtë do të jetë për të gjurmuar njerëz që kanë shqetësuar apo mërëzitur fëmijën tuaj. Po ashtu prindërit duhet të përdorin softuer për të bllokuar ngacmuesit dhe të vendosin opsionin e privatësisë (privacy settings) në faqet e rrjeteve sociale.

Tregoni fëmijëve tuaj se ata nuk duhet të pranojnë asnjë aktivitet online që ka për qëllim ti frikësojë, kërcënojë ose të dëmtojë ata apo dikë tjetër. Kushtimi i vëmendjes është pikërisht çfarë ngacmuesit kërkojnë, andaj injoroni ata sa më shumë që të jetë e mundur.

Inkurajoni fëmijët tuaj të flasin me ju, nëse dikush thotë apo bën diçka në internet që i bën ata të ndjehen pakëndshëm ose të kërcënuar. Qëndroni të qetë, për të mbajtur hapur linjat e komunikimit me fëmijët tuaj. Sigurohuni që fëmijët tuaj të ju tregojnë kujdestarëve të tyre nëse dikush nga nxënësit në shkollë i ngacmon ata. Nëse ju ose fëmijët tuaj janë kërcënuar nga ndokush, lajmëroni policinë lokale.

Vëreni nëse fëmija juaj shfaq shenja paralajmëruese të sajberdhunës, si për shembull hezitimi për të përdorur kompjuterin, ndonjë ndryshim i shfaqur në sjelljen dhe disponimin e tij ose ngurrimi për të shkuar në shkollë.

Tregojni fëmijëve tuaj se njerëzit me të cilët ata shoqërohen online kanë qasje të pakufizuar në materialet e postuara nga fëmijët dhe ata mund të dërgojnë këto informata diku tjetër në internet ose ta përdorin kundër tyre.

Fëmijët duhet të kuptojnë se ata të cilët i ngacmojnë fëmijët në internet, dëshirojnë që fëmija të bëhet viktimë e tyre dhe të ndjehen sikur diçka nuk është në rregull ta. Prandaj, është me rëndësi që fëmijët ta dinë se nuk ka asgjë të keqe me ta, mirëpo problemi i vërtetë janë pikërisht sajberdhunuesit që ngacmojnë fëmijët .

Statistika

Rezultatet nga hulumtimi i Qendrës FIT me fëmijët e moshës 9 -16 vjet i mbajtur në Prill 2012 në Prishtinë tregojnë se:

- 37% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë përjetuar sajberdhunën në 12 muajt e fundit.
- 41% e sajberdhunës është e bërë përmes rrjeteve sociale, 37% përmes mesinxherit, 15% përmes e-mailave, 15% nga lojrat dhe 12% përmes formave të tjera.
- 28% nuk kanë biseduar me dikë lidhur me sajberdhunën e përjetur në internet, ku dominojnë djemtë me 36% dhe fëmijët e moshës 13-16 vjeç 35%.
- 33% Kanë deklaruar se vetë kanë ushtruar sajberdhunë ndaj të tjerëve, prej të cilëve 9% e kanë bërë 'çdo ditë apo çdo gjatë javës'.
- 58% Kanë takuar dikë personalisht të cilin së pari e kanë njohur përmes internetit prej të cilëve 27% janë shqetësuar (penguar, nervozuar, mërëzitur, lënduar) nga këto takime.



Qendra për studime të avancuara
Center for advanced studies



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

 Internet i Sigurt

www.internetisigurte.org

Sajberdhuna



Çfarë është Sajberdhuna?

Sajberdhuna është përdorimi i qëllimshëm dhe i përsëritur i mjeteve elektronike (si psh. internetin apo telefonin mobil) nga fëmijët dhe adoleshentet për të ngacmuar, kërcënuar, munduar, poshtëruar, turpëruar apo përdorimi i ndonjë forme tjetër e të dhunës ndaj një fëmije apo adoleshenti tjetër.

Llojet e sajberdhunës?


Ka shumë forma të sajberdhunës, mirëpo këto janë më të shpeshtat:

- Dërgimi i e-mailave që mund të jenë kërcënues apo shqetësues (psh. mesazhe fyese, raciste apo paragjykime të tjera);
- Dërgimi ose postimi i thashethemeve të shokët apo direkt të viktimeve;
- Postimet në rrjetet sociale — psh. i sekreteve të dikujt (p.sh. Facebook ose Twitter);
- Fyerja e fëmijëve duke ju vënë nofka apo pseudonime përmes mesazheve, komunikimit në chat, postimit në facebook, etj.;
- Dërgimi ose postimi i fotografive të personave të tjerë, pa lejen e tyre (zakonisht fotografi turpëruese ose intime/personale) në internet.
- Krijimi i profileve apo uebfaqeve të caktuara në internet duke shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh me qëllim talljeje apo fyerjeje.

Metodat dhe teknologjia e përdorur

Fëmijët përdorin metoda dhe teknologji të ndryshme për të ushtruar sajberdhunë, mirëpo më të shpeshtat janë këto:

- Telefonatat, mesazhet përmes telefonit;
- E-mailat apo mesazhet e çastit (msn);
- Fotografitë digjitale (nga aparatet digjitale dhe telefonat mobil);
- Dhomat e chat-it, dhomat e diskutimit dhe grupet e ndryshme të chat-it në internet;
- Uebfaqet e dedikuara ndaj dikujt për të shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh. Liria e shprehjes është e garantuar për të gjithë, mirëpo shpesh uebfaqet e tilla ngacmojnë në vazhdimësi një fëmijë apo grupe të caktuar fëmijësh, dhe një sulm i tillë bëhet barrë për individët e sulmuar, duke iu pamundësuar funksionim normal të jetës së tyre.



Përse fëmijët ngacmojnë njëri-tjetrin?

Fëmijët shpeshherë ngacmojnë nëpërmjet internetit të motivuar nga zemërimi, hakmarrja ose inati. Nganjëherë ngacmojnë të tjerët për zbavitje apo ngase janë të mërzitur dhe kanë tepër kohë të lirë.

Shpesh, është vështirë të përcaktohet toni i dërguesit. Shakaja e një personi mund të jetë ofendim i rëndë për një person tjetër! Mirëpo, dërgimi i njëpasnjëshëm i e-mailave, mesazheve, dhe postimeve është rrallëherë i paqëllimshëm.



Parandalimi i sajberdhunës

Ju mund të ndërmerri disa hapa për të parandaluar sajberdhunën:

- Mos iu përgjigj ngacmuesve. Mos i lexoni mesazhet e tyre, bllokoni ata persona dhe mos komunikoni me ta;
- Asnjëherë mos u hakmerrni ndaj atyre që ju ngacmojnë;
- Mos i tregoni askujt fjalëkalimet tuaja, përveç prindërve tuaj;
- Është e rëndësishme t'ju tregoni prindërve tuaj nëse bëheni viktimë e ngacmimit;
- Ruani dëshmitë lidhur me ngacmimet online;
- Mundohuni ta identifikoni personin i cili ju ngacmon!

Pasoja të sajberdhunës

Viktimat e sajberdhunës pësojnë të njëjtat efekte negative sikurse ngacmimi në jetën e përditshme, por shpesh efektet e sajberdhunës janë më të mëdha për shkak se mesazhet mund të bëhen publike dhe mund të shihen nga një audiencë e madhe e pa kufi.

Rreziku më i madh vjen nga fakti se ky abuzim i filluar nëpërmjet internetit, shpesh nuk ndalet me atë, mirëpo mund të vazhdojë t'i ndjek fëmijët edhe në jetën e përditshme duke i shqetësuar ata gjatë aktiviteteve ditore e duke ndikuar në jetën normale të tyre.

